

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, më Gjyqtaren Ilirjana Hoti dhe sekretaren juridike Flutur Nagavci, në lëndën penale kundër të akuzuarës F. P. nga fsh. D. K. Gjakovë, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik neni 378 par.7 dhe 6 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Departamenti-Përgjithshëm në Gjakovë, PP.nr.1541/2015 të dt. 18.04.2016, duke vendosur në lidhje me propozimin e PTHDP-Gjakovë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me dt.06.07.2016, murr ketë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-DP ne Gjakovë PP.nr.1541/2015 e dt.18.04.2016, dhe kjo Gjykatë, jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

E akuzuara:

F. P., e bija e I. dhe nënës S. e gjinisë K., e lindur me dt..., në fsh. D. K. Gjakovë, ku edhe tani banon, studente, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse :

- Më dt.05.11.2015, rreth orës 12:00 min. në aksin rrugorë Gjakovë-Ponoshec përderisa ishte duke drejtuar automjetin e markës "WV Golf" me targa të regjistrimit..., e pandehura ka rrezikuar trafikun publik, pasurinë në përmasa të mëdha dhe jetën e të dëmtuarve L. D., L. S., S. P. dhe D. D.. Duke e drejtuar automjetin në kundërshtim me nenin 42 dhe 61 të Ligjit për Sigurinë në Komunikacioni Rrugorë ashtu që, derisa po qarkullonte në rrugën e fshatit Meje në drejtim të Gjakovës, me të arritur tek udhëkryqi me rrugën magjistrale, saktësisht në afërsi të pompës së derivateve "Z/D-Petroll", pa u siguruar mirë merr veprim të gabuar duke mos e respektuar shenjën e trafikut "Stop" rrugë me përparësi dhe si pasojë e kësaj pakujdesie kyqet në udhëkryq duke ia marrë përparësinë e kalimit automjetit të markës "WV Jetta" me targa të regjistrimit..., të cilin po e drejtonte i dëmtuari L. D., i cili në momentin kritik ishte në lëvizje përgjatë rrugës magjistrale në drejtim të fshatit Ponoshec dhe në pamundësi që ti shmanget aksidentit me pjesën ballore të automjetit e godet në pjesën anësore të anës së majtë automjetin që po e drejtonte e pandehura, me ç'rast shkaktohen dëme materiale si dhe pësojnë lëndime trupore të dëmtuarit më për se afërmi të përshkruara në Raportin e mjekut-ligjor Dr. M. G., me Nr. të Ref. Gja-318/16 të dt. 05.03.2016.

-me çka ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 7 dhe 6 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata konform nenit 4,41,43, 46,73,dhe nenit 378 par. 7 dhe 6 te KPRK-së ,si dhe nenit 495 te KPPK-se, të akuzuarën e,

G J Y K O N

F. P., i cakton dënimin me gjobë në shumë prej **200,00.-€ (dyqind euro)**, të cilën shumë është e obliguar që ta paguaj në afat prej **15 ditësh**, pas plotfuqishmërisë, së këtij Aktgjykimi -Urdhri ndëshkimor, në kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Nëse, dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma të tjera të parapara sipas nenit 46 të KPK-së, atëherë i njëjti dënim në bazë të nenit 49 par.4 të KPPK-së, do ti zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **10 (dhjetë)ditësh**, duke llogaritur për çdo ditë burgu nga **20.-€ (njëzet euro)**.

Të dëmtuarit –L. D., D. D., L. S. dhe S. P., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

E akuzuara obligohet që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën prej **90,88.-€** dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30,00.-€**, e këtë në afat prej **15 ditësh** pasi që Aktgjykimi-Urdhri ndëshkimor të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Pranë kësaj Gjykate Prokuroria Themelore- Departamenti i Përgjithshëm në Gjakovë, ka ngrit Aktakuzën PP.nr.1541/2015 e dt.18.04.2016, ndaj të akuzuarës F. P. nga fsh. D. K. Gjakovë, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 7 dhe 6 të KPRK-së.

Komfor nenit 493 të KPPK-së, PTH në Gjakovë, kësaj Gjykate i ka propozuar që ndaj të akuzuarës të lartcekur, pa mbajtur shqyrtimin gjyqësorë, të nxjerr urdhër ndëshkimor dhe të njëjtës t'i shqiptohet dënim me gjobë.

Para se të vazhdohet me arsyetim të Aktgjykimit për palët e pa udhëzuara është e nevojshme që t'i referohet dispozitës së nenit 378 par. 7 dhe 6 të KPRK-së e cila dispozitë për kryesit e kësaj vepre penale parasheh dënim me gjobë ose me burgim gjerë në 3 (tri) vjet.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes komfor nenit 495 të KPPK-se, gjeti se janë plotësuar kushtet nga dispozita e nenit 493 të KPPK-se dhe pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor, vendosi që të pranoi kërkesën e PTH –se në Gjakovë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të shqiptoj ndaj të akuzuarës dënim me gjobë si në dispozitiv të Aktgjykimit.

Gjykata vlerëson se provat që i janë bashkangjitur propozimit për dhënien e urdhrin ndëshkimor të cilat gjinden në shkresat e lëndës siç janë:

- Kallëzimi Penal i lëshuar nga DR e Policisë Gjakovë nr. ER-3004-269-15 i dt. 05.11.2015,
- Raporti mbi vend shikimin e aksidentit nga NJRT në Gjakovë ER-3004-269-15 i dt. 05.11.2015,
- Deklarata e të pandehurës F. P. dhënë në Stacioni Policor në Gjakovë, me dt.05.11.2015,
- Deklarata e të dëmtuarit L. D. dhënë në Stacioni Policor në Gjakovë, me dt.05.11.2015,
- Ekspertiza e Aksidentit në Komunikacione inxh. kom. J. M. PP.Nr.1541/2015 e dt. 29.11.2015,
- Ekspertiza mjeko-ligjore e Dr. M. G. me Nr.Ref. Gja-318/16 e dt. 05.03.2016,
- Foto-dokumentacioni nga vendi i ngjarjes, dhe shkresat tjera në lëndë.

Shkresat e lëndës janë prova të mjaftueshme me të cilat argumentohet se e akuzuara është kryese e veprës penale për të cilën akuzohet.

Gjykata këtë dënim e ka shqiptuar me bindje se me të njëjtit do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë në nenin 41 të KPK-së në mënyrë që të parandaloi kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar në nenin 463/2 të KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u murr konform nenit 450 par.2 dhe pika 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Me sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi mbi urdhrin ndëshkimor.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
P.nr.209/16 te dt. 06.07.2016

Sekretarja juridike:
Flutur Nagavci

Gjyqtarja
Ilirjana Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është i lejuar kundërshtimi në afat prej **8 ditësh**, nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjyqtares të kësaj Gjykate. Nëse e pandehura nuk ushtron kundërshtim, Aktgjykimi do të merr formë të prerë.